

**NJOFTIM MBI LISTËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK
PËR NGRITJE NË DETYRË
NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME
DREJTUESE**

Njësia Përgjegjëse, pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në zbatim të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar Kreu V – “Lëvizja paralele dhe Ngritja në detyrë”, nenit 26 si dhe të pikës 24, të Kreut III, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, në përfundim të afatit për pranimin e dokumentave si dhe verifikimit paraprak të kandidatëve, për përmbushjen e kushteve dhe kritereve të veçanta për ngritjen në detyrë, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, njofton se për pozicionin:

“Shef Sektori” 1 (një), në Sektorin Rregullator, Integritit dhe Procedurave “Shef Sektori” 1 (një), në Sektorin e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Integritit, pranë KDIMDP-së

Kategoria e pagës III-1.

Kandidatja e kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit është:

- Denada Hysi (ngritje në detyrë)

A. Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën 02.07.2024, ora 11:00, në ambjentet e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, adresa RR’Abdi Toptani, ND.5,Tiranë”

B. Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet pas testimit me shkrim. Për datën do të njoftoheni nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit.

Vëmendje: Në rast të ndryshimit të datës së testimit me shkrim, do të njoftoheni nëpërmjet faqes zyrtare, por edhe elektronikisht në emailin personal, të konfirmuar në dokumentacionin e dorëzuar.

Njësia Përgjegjëse